<p>ri/akreditim;</p> <p>5.3. Strategjitë dhe rregulloret e tjera zhvillimore;</p> <p>5.4. Rregulloret për sigurimin e cilësisë;</p> <p>5.5. Planin për zhvillimin e stafit akademik;</p> <p>5.6. si dhe rregullore dhe akte të tjera të cilat rregullojnë punën dhe funksionimin e institucionit të arsimit të lartë.</p>	<p>studijski program za koji aplicira za re- akreditaciju;</p> <p>5.3. Strategije i druge razvojne propise;</p> <p>5.4. Uredbe za obezbeđivanje kvaliteta;</p> <p>5.5. Plan za razvoj akademskog osoblja;</p> <p>5.6. kao i druge uredbe i akte koji uređuju rad i funkcionisanje institucije visokog obrazovanja.</p>	<p>accreditation;</p> <p>5.3. Strategies and other development regulations;</p> <p>5.4. Quality Assurance Regulations;</p> <p>5.5. Plan for the development of academic staff;</p> <p>5.6. As well as regulations and other acts that regulate the operation and functioning of the higher education institution.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13</p> <p style="text-align: center;">Përzgjedhja e vlerësuesve të jashtëm</p>	<p style="text-align: center;">Član 13</p> <p style="text-align: center;">Izbor spoljnih ocenjivača</p>	<p style="text-align: center;">Article 13</p> <p style="text-align: center;">Selection of external evaluations</p>
<p>1. Drejtori i AKA-së do të hartojë listën e vlerësuesve të jashtëm dhe do t'i propozojë ata tek Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) për miratim vjetor.</p> <p>2. Lista e vlerësuesve të jashtëm përbëhet nga emra të cilët rekomandohen nga agjencitë evropiane të akreditimit, anëtare të ENQA dhe/ apo EQAR, ekspertë ndërkombëtarë të vlerësimeve të jashtme si dhe ekspertë ndërkombëtarë të sigurimit të cilësisë të cilët shfaqin interesim/ aplikojnë për tu përfshirë në listën e vlerësuesve të</p>	<p>1. Direktor AKA-a će sačiniti spisak spoljnih ocenjivača i predložiti iste Državnom Savetu za Kvalitet (DSK) za godišnji odobrenje.</p> <p>2. Spisak spoljnih ocenjivača se sastoji od imena koji su preporučeni od strane Evropskih agencija za akreditaciju, članica ENQA i/ili EQAR, međunarodnih eksperata spoljašnjih ocenjivanja i međunarodnih eksperata osiguranja kvaliteta koji pokazuju interesovanje/ apliciraju za</p>	<p>1. The KAA Director will draft a list of external evaluators and proposes them to the State Quality Council (SQC) for annual approval.</p> <p>2. The list of external evaluators consists of names recommended by European accreditation agencies, members of ENQA and / or EQAR, International external evaluation experts as well as international quality assurance experts who are interested / apply to be included in the KAA's</p>

<p>jashtëm të AKA-së.</p> <p>3. Anëtarët e ekipit të vlerësuesve të jashtëm ndër të tjera duhet të plotësojnë kriteret në vijim:</p> <p>3.1. të jenë profesionistë në fushën përkatëse të vlerësimit dhe duhet të kenë përvojë në proceset e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit;</p> <p>3.2. Të kenë kualifikime shkencore PhD, përveç në rastet e programeve të studimit në arte dhe në programet profesionale ku grada shkencore e vlerësuesit të jashtëm duhet të jetë gradë ekuivalente artistike dhe profesionale MA. Kualifikimi shkencor PhD nuk aplikohet edhe për studentët vlerësues kualifikimi i të cilëve mund të jetë BA apo MA;</p> <p>3.3. të kenë njohuri dhe përvojë të mësimdhënies universitare në fushën përkatëse, përveç rasteve të studentëve vlerësues;</p> <p>3.4. të kenë kërkime shkencore në një fushë të caktuar dhe njohuri lidhur me aktivitetet kërkimore shkencore;</p> <p>3.5. të kenë përvojë në menaxhimin dhe</p>	<p>uklucivnje u spisak spoljnih ocenjivača AKA-a.</p> <p>3. Članovi tima spoljnih ocenjivača između ostalog treba da ispunjavaju sledeće kriterijume:</p> <p>3.1. Da su profesionalci u relevantnoj oblasti i treba da imaju iskustva u procesima procene kvaliteta i akreditacije;</p> <p>3.2. Da imaju naučne kvalifikacije PhD, osim u slučajevima studijskih programa u oblasti umetnosti i stručnih programa u kojima stručni stepen spoljnih ocenjivača treba da bude ekvivalentni umetnički i stručni stepeni MA. Naučna Kvalifikacija PhD se ne primenjuje i za studente ocenjivača čija kvalifikacija može biti BA ili MA;</p> <p>3.3. Da imaju znanja i iskustvo univerzitetske nastave u relevantnoj oblasti, osim slučajeva studenta ocenjivača;</p> <p>3.4. da imaju naučna istraživanja u određenoj oblasti i znanje o naučno-istraživačke delatnosti;</p> <p>3.5. Da imaju iskustvo u upravljanju i</p>	<p>external evaluators list.</p> <p>3. The members of the external evaluation team, among others, must meet the following criteria:</p> <p>3.1. To be professionals in the relevant evaluation field and should have experience in quality assessment and accreditation processes;</p> <p>3.2. To have PhD scientific qualifications, except in the case of study programs in arts and in professional programs where scientific degrees of external evaluators should be equivalent artistic and professional MA degree. The PhD scientific qualification does not apply for students evaluators whose qualifications may be BA or MA;</p> <p>3.3. To have knowledge and experience of university teaching in the relevant field, except in cases of the student evaluators;</p> <p>3.4. To have scientific researches in a particular field and knowledge about scientific research activities;</p> <p>3.5. To have experience in</p>
---	--	---

<p>sigurimin e cilësisë në një institucion të arsimit të lartë;</p> <p>3.6. të kenë përvojë pune brenda strukturave organizative dhe administrative të një institucioni apo njohuri për sistemet menaxhuese;</p> <p>3.7. të kenë përvojë në zhvillimin, realizimin dhe vlerësimin e kurrikulave;</p> <p>4. AKA i propozon institucionit të arsimit të lartë përbërjen e ekipit të vlerësuesve të jashtëm si dhe datën e vizitës në institucion.</p> <p>5. Institucioni i arsimit të lartë ka të drejtë të kundërshtojë përbërjen e ekipit të vlerësuesve të jashtëm. Vetëm nëse AKA pajtohet se ka arsye të bazuar për kundërshtim, siç mund të jetë njëanshmëria apo konflikti i interesit, AKA do të caktojë vlerësuesin (-ët) zëvendësues.</p> <p>6. Të gjithë vlerësuesve të jashtëm do t'iu kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë të konfidencialitetit përmes së cilës ata zotohen se nuk do ta përcjellin asnjë informatë që del nga procesi tek një</p>	<p>osiguravaniu kvaliteta u nekoj od institucija visokog obrazovanja;</p> <p>3.6. Da imaju iskustva u radu u okviru organizacionih i administrativnih struktura jedne institucije ili znanja o sistemu za upravljanje;</p> <p>3.7. Da imaju iskustvo u razvoj, realizaciju i ocenjivanje Kurrikuluma;</p> <p>4. AKA preporučuje instituciji visokog obrazovanja sastav tima spoljnih ocenjivača i datum posete u instituciji.</p> <p>5. Institucija visokog obrazovanja ima pravo da se protivi sastavu tima spoljnih ocenjivača. Samo ukoliko se AKA slaže da postoje osnovni razlozi da se suprotstavi, kao što može biti pristrasnost ili sukob interesa, AKA će imenovati zamenike ocenjivača.</p> <p>6. Svim spoljnim ocenjivačima će se tražiti da potpišu izjavu o poverljivosti kojom se obavezuju da neće preneti bilo kakvu informaciju koja izlazi iz procesa do treće strane.</p>	<p>management and provision of quality in a higher education institution;</p> <p>3.6. To have work experience within an organizational and administrative structure of an institution or knowledge of managing systems;</p> <p>3.7. To have experience in the development, implementation and evaluation of curricula;</p> <p>4. KAA proposes to the Higher Education Institution the composition of the team of external evaluators and the date of the site visit to the institution.</p> <p>5. The higher education institution has the right to object to the composition of the external evaluator's team. Only if the KAA agrees that there are grounds for objection, such as conflict of interest, the KAA will assign the substitute evaluator(s).</p> <p>6. All external evaluators will be required to sign a confidentiality statement through which they pledge that they will not convey any information arising from the</p>
--	---	---

<p>palë e tretë.</p> <p>7. Vlerësuesit e jashtëm do të nënshkruajnë edhe deklaratën e shmangies nga çdo formë e konfliktit të interesit me institucionin që është në procedurë të vlerësimit sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.</p>	<p>7. Spoljni ocenjivači će potpisati i izjavu o odstupanju od bilo kojeg oblika sukoba interesa sa institucijom koja je u proceduri ocenjivanja prema važećem zakonodavstvu na Kosovu.</p>	<p>process to a third party.</p> <p>7. External evaluators will sign also a declaration to avoid any form of conflict of interest with the institution that is in the evaluating procedure under the legislation in force in Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Përbërja e ekipit të vlerësuesve të jashtëm</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Sastav tima spoljnih ocenjivača</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 The composition of the external teams of evaluators</p>
<p>1. Secili ekip i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga minimum 2 deri maksimum 7 vlerësues të jashtëm/, varësisht nga numri i programeve të studimit që vlerësohen.</p>	<p>1. Svaki tim za spoljno ocenjivanje se sastoji od minimalno 2 do maksimalno 7 spoljnih ocenjivača, u zavisnosti od roja studijskih programa koji se ocenjuju.</p>	<p>1. Every external evaluation team consists of a minimum of 2 to a maximum of 7 external evaluators, depending on the number of study programs that are under evaluation.</p>
<p>2. Në ekipin e vlerësuesve të jashtëm do të emërohet të paktën një student për të vlerësuar çështjet studentore gjatë vlerësimit të institucionit të arsimit të lartë.</p>	<p>2. U timu spoljnih ocenjivača će biti imenovan najmanje jedan student da proceni studentska pitanja tokom ocenjivanja institucije visokog obrazovanja.</p>	<p>2. In the team of external evaluators at least one student will be appointed to evaluate students matters during the evaluation of the higher education institution.</p>
<p>3. Vlerësuesit e jashtëm të njëjtë mund të përdoren për të vlerësuar programe të ngjashme në institucione të ndryshme.</p> <p>4. Njëri nga anëtarët e ekipit të vlerësuesve të jashtëm do të caktohet</p>	<p>3. Isti spoljni ocenjivači se mogu koristiti za ocenjivanje sličnih programa u različitim institucijama.</p> <p>4. Jedan od članova tima spoljnih ocenjivača će biti imenovan za</p>	<p>3. The same external evaluator can be used to evaluate similar programs in different institutions.</p> <p>4. One of the members of the external evaluators' team will be appointed</p>

<p>si kryesues i ekipit dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe koordinimin e hartimit të Raportit të vlerësimit.</p>	<p>rukovodioca tima i odgovoran je za nadgledanje i koordinaciju izrade izveštaja o ocenjivanju.</p>	<p>as the Chair of the Team and he/she shall be responsible for overseeing and coordinating the drafting of the Evaluation Report.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 15 Detyrat e vlerësuesve të jashtëm</p>	<p style="text-align: center;">Član 15 Zadaci spoljnih ocenjivača</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Duties of the external evaluators</p>
<p>1. Detyrat kryesore të vlerësuesve të jashtëm janë:</p> <p>1.1. Shqyrtimi i dokumenteve të dorëzuara nga institucioni para vizitës në institucion;</p> <p>1.2. Realizimi i vizitës në institucionin e arsimit të lartë të aranzhuar nga AKA;</p> <p>1.3. Hartimi i draft raportit të vlerësimit pas vizitës së realizuar në terren;</p> <p>1.4. Shqyrtimi i komenteve të dorëzuara nga institucioni për gjendjen faktike të draft raportit;</p> <p>1.5. Finalizimi i raportit të vlerësimit për institucionin e arsimit të lartë.</p> <p>1.6. Dorëzimi i raportit të vlerësimit në AKA.</p>	<p>1. Glavni zadaci spoljnih ocenjivača su:</p> <p>1.1. Razmatranje dostavljenih dokumenata od strane institucije pre posete u instituciji;</p> <p>1.2. Realizacija posete u instituciji visokog obrazovanja koju je organizovao AKA;</p> <p>1.3. Izrada nacrtu izveštaja o ocenjivanju nakon realizovane posete na terenu;</p> <p>1.4. Razmatranje komentara dostavljenih od strane institucije za činjenično stanje nacrtu izveštaja;</p> <p>1.5. Okončanje izveštaja o ocenjivanju za institucije visokog obrazovanja.</p> <p>1.6. Podnošenje izveštaja o ocenjivanju u AKA.</p>	<p>1. The main duties of external evaluators are:</p> <p>1.1. Review of documents submitted by the institution prior to the site visit to the institution;</p> <p>1.2. Carrying out the site visit to the higher education institution arranged by the KAA;</p> <p>1.3. Drafting the draft evaluating report after the site visit;</p> <p>1.4. Reviewing comments submitted by the institution on the factual situation of the draft report;</p> <p>1.5. Finalization of the evaluation report for the Higher Education Institution.</p> <p>1.6. Submission of the final evaluation report to KAA.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 16 Vizita në institucion e ekipit të vlerësuesve të jashtëm</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Poseta instituciji od strane tima spoljnih ocenjivača</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Site visit of the external evaluators' team to the institution</p>
<p>1. Vizitat tek institucionet duhet të strukturohen për të përmbushur kërkesat e procesit të akreditimit të caktuar (akreditimi fillestar institucional, programet e reja akademike ose riakreditimet) dhe duhet të koordinohen me institucionin.</p>	<p>1. Posete institucijama treba da budu strukturane da bi ispunila zahteve procesa određene akreditacije (početna institucionalna akreditacija, novi akademski programi ili reakreditacija) i treba da se koordiniše sa institucijom.</p>	<p>1. Site visits to the institution should be structured to meet the requirements of the specific accreditation process (initial institutional accreditation, new academic programs or reaccreditations) and should be coordinated with the institution.</p>
<p>2. Si masë përgatitore, ekipi i vlerësuesve të jashtëm duhet të pranojë të gjitha dokumentet e aplikacionit, përfshirë raportin e vet vlerësimit të institucionin nën vlerësim, dhe të gjitha informatat e nevojshme për vizitën në institucion të paktën dy javë para vizitës në institucion.</p>	<p>2. Kao pripremnu meru, tim za spoljno ocenjivanje mora da dobije svu aplikacionu dokumentaciju, uključujući izveštaj samog ocenjivanja i pod-ocenjivanja institucije, i sve neophodne informacije za posetu instituciji najmanje dve nedelje pre posete u instituciji.</p>	<p>2. As a preparatory measure, the external evaluators' team should receive all application documents, including the evaluation report of the institution under evaluation, and all necessary information on the site visit at least two weeks prior to the site visit.</p>
<p>3. Secila vizitë në institucion zgjat një deri në dy ditë, varësisht nga numri i programeve nën vlerësim.</p>	<p>3. Svaka poseta instituciji traje jedan do dva dana, u zavisnosti od broja programa u okviru procene.</p>	<p>3. Each site visit to the institution shall last one to two days, depending on the number of programs under evaluation.</p>
<p>4. Gjatë vizitës, vlerësuesit e jashtëm do të kenë diskutime me grupe të ndryshme të individëve që</p>	<p>4. Tokom posete, spoljni ocenjivači će imati razgovore sa različitim grupama pojedinaca koji</p>	<p>4. During the site visit, external evaluators will have discussions with different groups of</p>

<p>përfaqësojnë funksione të ndryshme brenda institucionit.</p> <p>5. Gjatë vizitës, ekipi i vlerësuesve të jashtëm do të shoqërohet nga një zyrtar i AKA-së i cili ka rolin e koordinatorit të procesit.</p> <p>6. Institucioni ka të drejtë të tërheq aplikacionin për ri/akreditim gjatë kohës së vizitës së ekipit të vlerësuesve të jashtëm, apo në çdo kohë pas vizitës.</p> <p>7. Në rast të tërheqjes së aplikacionit për ri/akreditim, institucioni rezervon të drejtën për të aplikuar përsëri.</p>	<p>predstavljaju različite funkcije unutar institucije.</p> <p>5. Tokom posete, tim spoljnih ocenjivača će biti u pratnji zvaničnika AKA-a koji ima ulogu koordinatora procesa.</p> <p>6. Institucija ima pravo da povuče aplikaciju za re-akreditaciju prilikom posete tima spoljnih ocenjivača, ili u bilo kom trenutku nakon posete.</p> <p>7. U slučaju povlačenja aplikacije za re-akreditaciju, institucija zadržava pravo za ponovno apliciranje.</p>	<p>individuals representing different functions within the institution.</p> <p>5. During the site visit, the team of external evaluators will be accompanied by a KAA official staff whose role shall be coordinator of the process.</p> <p>6. The institution has the right to withdraw the application for re/accreditation during the site visit of the external evaluators' team, or at any time after the site visit.</p> <p>7. In case of withdrawal of re/accreditation application, the institution reserves the right to apply again.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 17 Raporti i vlerësimit</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Izveštaj ocenjivanja</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 The evaluation report</p>
<p>1. Ekipi i vlerësuesve të jashtëm e harton Raportin e vlerësimit duke u bazuar në dëshmitë e mbledhura gjatë vizitës në terren, përmbajtjes së Raportit të Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin tjetër të bashkangjitur.</p> <p>2. Ekipi i vlerësuesve të jashtëm i</p>	<p>1. Tim spoljnih ocenjivača izrađuje izveštaj o ocenjivanju na osnovu prikupljenih dokaza tokom posete na terenu, sadržaja izveštaja ocenjivanja i ostalu priloženu dokumentaciju.</p> <p>2. Tim spoljnih ocenjivača održava se</p>	<p>1. The external evaluators' team compiles the evaluation report based on the evidenced collected during the on-site visit, based on the content of the Self-evaluation report and other attached documentation.</p> <p>2. The external evaluators' team</p>

<p>përmbahet Udhëzuesve të AKA-së për hartimin e raporteve të vlerësimit të ofruara nga AKA.</p> <p>3. Raporti duhet të përmbillet me një rekomandim për akreditim ose refuzim të akreditimit, e po ashtu edhe me rekomandime për përmirësimin e cilësisë së institucionit.</p> <p>4. Raporti duhet të bazohet në konsensusin e ekipit të vlerësuesve të jashtëm. Në rast se në disa pika nuk arrihet asnjë konsensus, atëherë do të përpilohet një deklaratë e cila do ti bashkëngjitet Raportit në formë të sqarimit.</p> <p>5. AKA e dërgon draft raportin e vlerësimit tek institucioni. Institucioni ka të drejtë të dorëzojë komente me shkrim mbi raportin fillestar të vlerësuesve të jashtëm. Komentet mund të mbulojnë çfarëdo informacioni faktik të përfshirë në raport, por jo në rekomandimet e dhëna nga vlerësuesit e jashtëm. Komentet duhet të dorëzohen në AKA më së largu brenda dy (2) javësh pas pranimit të draft raportit.</p>	<p>smernicama AKA-a za izradu izveštaja ocenjivanja, koje pruža AKA.</p> <p>3. Izveštaj treba da se zaključi sa preporukom za akreditaciju ili odbijanje akreditacije, kao i sa preporukama za poboljšanje kvaliteta institucije.</p> <p>4. Ovaj izveštaj treba da se zasniva na konsenzusu spoljnog tima za ocenjivanje. U slučaju da u nekim tačkama ne se postigne nijedan konsensus, onda će se sastaviti izjava koja će biti priložena izveštaju u vidu pojašnjenja.</p> <p>5. AKA šalje nacrt izveštaj ocenjivanja instituciji. Institucija ima pravo da podnese pisane komentare o preliminarnom izvještaju spoljašnji ocenjivača. Komentari mogu pokriti bilo kakve činjenične informacije obuhvaćen izveštajem, ali ne i u preporukama datim od strane spoljašnji ocenjivača. Komentari moraju biti dostavljeni u AKA najkasnije u roku od dve (2) nedelje nakon usvajanja nacrt izvještaja.</p>	<p>complies with the KAA guidelines for drafting evaluation reports provided by KAA.</p> <p>3. The report should contain the final recommendation for accreditation or refusal of accreditation, as well as with other recommendations for improving the quality of the institution.</p> <p>4. The report should be based on the consensus of the external evaluators' team. If there's no consensus reached at some points, then a statement will be compiled which will be attached to the Report in the form of clarification.</p> <p>5. KAA submits the draft evaluation report to the institution. The institution has the right to submit written comments on the draft report of external evaluators. Comments can cover any factual information contained in the report, but not on recommendations given by external evaluators. The comments must be submitted to KAA at the latest within two (2) weeks of the draft report receipt.</p>
--	---	---

<p>6. Ekipi i vlerësuesve të jashtëm mund të përmirësojë draft raportin duke u bazuar në komentet e dorëzuara nga institucioni nëse institucioni ka dorëzuar të komente të qëndrueshme mbi gjendjen faktike dhe do ta dorëzojë Raportin përfundimtar në AKA, jo më vonë se katër (4) javë pas vizitës së bërë në terren.</p>	<p>6. Tim spoljnih ocenjivača može poboljšati nacrt izveštaj na osnovu dostavljenih komentara od strane institucije ukoliko je institucija dostavila stabilne komentare o činjeničnom stanju i će podneti završni izveštaj u AKA najkasnije u roku od četiri (4) nedelje nakon posete na terenu.</p>	<p>6. The team of external evaluators may change the draft report based on the comments submitted by the institution, if the institution has submitted sustained comments on the factual situation and will submit the final report to the KAA, not later than four (4) weeks after the site visit.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 18 Vendimi për akreditim</p>	<p style="text-align: center;">Član 18 Odluka za akreditaciju</p>	<p style="text-align: center;">Article 18 Decision for accreditation</p>
<p>1. Drejtori i AKA-së harton një përmbledhje të raportit duke u bazuar në raportin e vlerësimit të ekipit të vlerësuesve të jashtëm dhe ia paraqet atë KSHC-së.</p> <p>2. Duke u bazuar në rekomandimet nga raporti i vlerësuesve të jashtëm, KSHC merr vendim për akreditim ose mos akreditim.</p> <p>3. Përjashtimisht, KSHC mund të merr vendim ndryshe nga rekomandimi i vlerësuesve të jashtëm, nëse KSHC konstaton se gjendja faktike e vërtetuar e raportit nuk është në përputhje me rekomandimin final të vlerësuesve të jashtëm.</p>	<p>1. Direktor AKA-a sastavlja sadržaj izveštaja na osnovu izveštaja o ocenjivanju spoljnog tima za ocenjivanje i predstaviće ga Državnom savetu za kvalitet.</p> <p>2. Na osnovu preporuka iz izveštaja spoljnih ocenjivača, DSK će odlučiti o akreditaciji ili ne-akreditaciji.</p> <p>3. Izuzetno, DSK može odlučiti drugačije od preporuka spoljnih ocenjivača, ukoliko DSK konstatuje da potvrđeno faktičko stanje izveštaja nije u skladu sa konačnom preporukom spoljnih ocenjivača.</p>	<p>1. The KAA Director shall compile a summary of the evaluation report based on the external evaluation report and submits it to SQC.</p> <p>2. Based on recommendations given in the report of external evaluators, SQC takes a decision on accreditation or non-accreditation.</p> <p>3. Exceptionally, the SQC may make a decision different from the recommendation of external evaluators if the SQC determines that the factual status of the report is not in accordance with the final recommendation of the external</p>

<p>4. KSHC i merr vendimet për akreditim me shumicë të votave të anëtarëve të vet. Asnjë vendim i KSHC-së për akreditim/riakreditim apo refuzim të aplikacionit përkatësisht mosakreditim të institucionit apo programeve të studimit nuk mund të merret pa pjesëmarrjen e të paktën një anëtari ndërkombëtarë.</p>	<p>4. DSK donosi odluke o akreditacii na osnovu apsolutne većine njenih članova. Nijedna odluka DSK-a o akreditacii/reakreditacii ili odbijanja aplikacije, odnosno ne-akreditacija institucije ili studijskih programa ne može se doneti bez učešća najmanje jednog međunarodnog člana.</p>	<p>evalautors. 4. SQC takes decisions for accreditation by majority of votes of its members. No SQC decision on accreditation / re-accreditation or refusal of application, respectively non-accreditation of the institution or study programs can be taken without the participation of at least one international member.</p>
<p>5. Vendimi i KSHC-së për ri/akreditim duhet t'i komunikohet institucionit në formë të shkruar.</p>	<p>5. Odluka DSK-a o reakreditacii treba se saopštiti instituciji u pisanoj formi.</p>	<p>5. The SQC's decision on re-accreditation should be communicated to the institution in written form.</p>
<p>6. Në rastin e ri/akreditimit të programeve, vendimi do të tregojë qartë cilat programe janë akredituar dhe do të saktësojë emrat e titujve dhe diplomave që mund të jepen.</p>	<p>6. U slučaju reakreditacije programa, odluka će jasno pokazati koji su programi akreditovani i navešće imena zvanja i diploma koja mogu biti dodeljena.</p>	<p>6. In case of program reaccreditation, the decision will clearly show which programs are re/accredited and will precise name of titles and diplomas that will be given.</p>
<p>7. Në rastin e vendimeve për mos akreditim, AKA do të tregojë qartë arsyet për refuzimin e akreditimit të programeve të studimit.</p>	<p>7. U slučaju odluka za ne-akreditaciju, AKA će jasno ukazati na razloge za odbijanje akreditacije programa studija.</p>	<p>7. In case of decisions for non-accreditation, KAA will clearly indicate reasons for denial of the study programs.</p>
<p>8. AKA do të publikojë në ueb faqen e saj vendimet për ri/akreditim si dhe</p>	<p>8. AKA će na svojoj veb stranici objaviti</p>	<p>8. KAA will publish on its web site the</p>

<p>raportin e vlerësimit të vlerësuesve të jashtëm për çdo institucion të arsimit të lartë dhe program studimi.</p> <p>9. AKA do të njoftojë MASHT-in për të gjitha vendimet për ri/akreditim të KSHC-së, në mënyrë që MASHT të vazhdojë procedurën e licencimit sipas UA për Licencim.</p> <p>10. Nëse një institucion i arsimit të lartë nuk arrin të ri/akreditohet në nivelin institucional, kjo do të rezultojë me organizimin e një procesi tjetër të ri/akreditimit jo më vonë se brenda një viti.</p> <p>11. Nëse institucioni i arsimit të lartë dështon të ri/akreditohet në nivelin institucional për herën e dytë, AKA do të njoftojë MASHT për të proceduar tutje me tërheqjen e licencës së institucionit.</p>	<p>odluke o reakreditaciji, kao i izveštaj procene spoljnih ocenjivača za svaku instituciju visokog obrazovanja i studijskih programa.</p> <p>9. AKA će obavestiti MONT o svim odlukama za reakreditaciju DSK-a, kako bi MONT nastavio proceduru licenciranja u skladu sa AU-om za licenciranje.</p> <p>10. Ukoliko institucija visokog obrazovanja bude neuspešna u reakreditaciji na institucionalnom nivou, to će rezultirati organizacijom drugog procesa reakreditacije ne kasnije od godinu dana.</p> <p>11. Ukoliko se institucija visokog obrazovanja po drugi put pokazuje neuspešnom u reakreditaciji na institucionalnom nivou, AKA će obavestiti MONT o daljim procedurama sa povlačenjem licence institucije.</p>	<p>re-accreditation decisions as well as the external evaluators' report of each higher education institution and each study program.</p> <p>9. KAA will notify MEST of all SQC re/accreditation decisions in order for MEST to proceed with the licensing procedure according to the AI for Licensing.</p> <p>10. If an institution of higher education fails to be re/accredited at the institutional level, this will result in the organization of another re/accreditation process not later than within one year.</p> <p>11. If the higher education institution fails to be re-accredited at the institutional level for the second time, KAA will notify MEST to proceed with withdrawal of the institution's license.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 19 Kohëzgjatja e akreditimit</p> <p>1. Kohëzgjatja e akreditimit institucional fillestar (paraprak) është tri (3) vjet</p>	<p style="text-align: center;">Član 19 Vreme trajanja akreditacije</p> <p>1. Vremensko trajanje za akreditaciju nove institucije (preliminarno) je tri</p>	<p style="text-align: center;">Article 19 Duration of accreditation</p> <p>1. The duration of initial (preliminary) institutional accreditation is three</p>

<p>dhe e ri/akreditimit jo më shumë se pesë (5) vjet, përveç rasteve ku ekipi i vlerësuesve të jashtëm rekomandon një kohëzgjatje tjetër dhe kur ai rekomandim merr pajtimin e KSHC-së.</p> <p>2. Kohëzgjatja e ri/akreditimit të programit është tri (3) deri në pesë (5) vjet, përveç rasteve ku ekipi i vlerësuesve të jashtëm rekomandon një kohëzgjatje tjetër dhe kur ai rekomandim merr pajtimin e KSHC-së.</p>	<p>(3) godine i reakreditacije ne više od pet (5) godina, osim slučajeva kada tim spoljnih ocenjivača preporučuje drugi vremenski period i kad ta preporuka dobije saglasnost DSK-a.</p> <p>2. Vremensko trajanje reakreditacije programa je tri (3) do pet (5) godina, osim slučajeva kad ekipa spoljnih ocenjivača preporučuje drugo trajanje i kad ta preporuka dobije saglasnost DSK-a.</p>	<p>(3) years and of re/accreditation no longer than five (5) years, unless the team of external evaluators recommend another time limit and when that recommendation receives the SQC approval.</p> <p>2. The duration of the program re/accreditation is three (3) up to five (5) years, unless the team of external evaluators recommend another time limit and when that recommendation receives the SQC approval.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 20 Procedurat pas marrjes së ri/akreditimit</p>	<p style="text-align: center;">Član 20 Procedure nakon dobijanja reakreditacije</p>	<p style="text-align: center;">Article 20 Procedures after receiving the re/accreditation</p>
<p>1. Institucionet e akredituara duhet të dorëzojnë tek AKA në fillim të çdo viti akademik një raport vjetor gjithëpërfshirës mbi aktivitetet e tyre, duke përfshirë planin e përmirësimit (aktivitetet përcjellëse) të bazuar në rekomandimet e përfshira në raportin e ekipit të vlerësuesve të jashtëm.</p> <p>2. Institucionet e akredituara duhet ta njoftojnë AKA për të gjitha ndryshimet e rëndësishme të bëra,</p>	<p>1. Početkom svake akademske godine, akreditovane institucije treba da podnesu AKA-u sveobuhvatni godišnji izveštaj o svojim aktivnostima, uključujući plan poboljšanja (prateće aktivnosti) zasnovanim na preporukama obuhvaćenim u izveštaju ekipe spoljnih ocenjivača.</p> <p>2. Akreditovane institucije treba da obaveste AKA o svim učinjenim</p>	<p>1. Accredited institutions must submit a comprehensive annual report to the KAA at the beginning of each academic year on their activities, including the improvement plan (follow-up activities) based on the recommendations contained in the External Evaluators' Team Report.</p> <p>2. Accredited institutions should notify KAA of all important changes</p>

<p>duke përfshirë:</p> <p>2.1. Ndryshimin e pronësisë së institucionit;</p> <p>2.2. Ndryshimin e emrit të institucionit;</p> <p>2.3. Ndryshimin e Statutit të institucionit, pas aprovimit nga MASHT;</p> <p>2.4. Ndryshimin e rëndësishëm të programit (-ve) ekzistues të studimit;</p> <p>2.5. Ndryshimin në kontratat me stafin akademik;</p> <p>2.6. Ndryshimin e vendndodhjes së institucionit.</p>	<p>značajnim promenama, uključujući:</p> <p>2.1. Promenu vlasništva institucije;</p> <p>2.2. Promenu imena institucije;</p> <p>2.3. Promenu statuta institucije, nakon odobrenja od strane MONTA-a;</p> <p>2.4. Značajnu promenu postojećih programa studiranja;</p> <p>2.5. Promenu ugovora sa akademskim osobljem;</p> <p>2.6. Promenu mesta institucije.</p>	<p>made, including:</p> <p>2.1. Changing the institution's ownership;</p> <p>2.2. Changing the name of the institution;</p> <p>2.3. Changing the Statute of the institution, after approval by MEST;</p> <p>2.4. Significant changes of existing study program(s);</p> <p>2.5. Change in contracts with academic staff;</p> <p>2.6. Changing the location of the institution.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 21 Revokimi/tërheqja e akreditimit</p>	<p style="text-align: center;">Član 21 Opoziv/povlačenje akreditacije</p>	<p style="text-align: center;">Article 21 Revocation / withdrawal of accreditation</p>
<p>1. AKA e rezervon të drejtën të monitoroj dhe të kontrollojë cilësinë e institucioneve të akredituara në çfarëdo kohe me paralajmërim.</p> <p>2. AKA mund të rishqyrtojë akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe/ apo më pas të tërheq vendimin e saj për akreditim nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur.</p>	<p>1. AKA zadržava pravo da vrši nadzor i kontroliše kvalitet akreditovanih institucija u bilo kom vremenu i bez najavljivanja.</p> <p>2. AKA može da revidira dodeljenu akreditaciju u bilo kom vremenu i/ ili kasnije da povlači svoju odluku za akreditaciju ukoliko su uslovi dati prilikom akreditacije prekršeni.</p>	<p>1. KAA reserves the right to monitor and control the quality of accredited institutions at any time with or without prior notification.</p> <p>2. KAA may reconsider the given accreditation at any time and / or subsequently withdraw its decision on accreditation, if the given conditions in the case of accreditation have been violated.</p>

<p>3. Akreditimi mund të tërhiqet po ashtu në rastet kur është përcaktuar se aplikuesi ka dorëzuar informata dhe dokumentacione të rreme të cilat kanë ndikuar në dhënien e akreditimit.</p> <p>4. Akreditimi mund të tërhiqet nga KSHC nëse raporti i monitorimit nga vlerësuesit ndërkombëtarë konstaton se rekomandimet e vlerësuesve të jashtëm nuk janë implementuar sipas afateve kohore të përcaktuara në raportin e vlerësimit dhe/apo gjendja faktike në institucion është dëmtuar rëndë në aspektin e cilësisë.</p> <p>5. Në rast se AKA tërheq akreditimin e një institucioni në nivelin institucional, duhet të njoftojë MASHT.</p>	<p>3. Akreditacija može takode biti opozvana u slučajevima kada je definisano da je podnosilac zahteva dostavio netačne informacije i dokumente koji su uticali na dodeljivanju akreditacije.</p> <p>4. Akreditacija može biti opozvana od strane DSK-a ukoliko Izveštaj nadzora međunarodnih ocenjivača pokazuje da preporuke spoljnih ocenjivača nisu sprovedene u skladu sa vremenskim okvirima definisanim u izveštaju procene i/ili faktičko stanje institucije je ozbiljno oštećeno u pogledu kvaliteta.</p> <p>5. U slučaju da AKA opoziva akreditaciju jedne institucije na institucionalnom nivou, treba da obavesti MONT.</p>	<p>3. Accreditation may also be withdrawn in cases where it is confirmed that the applicant has submitted false information and documentation, based on which they initially were granted the accreditation.</p> <p>4. Accreditation may be withdrawn by SQC if the monitoring report by international evaluators ascertains that external evaluators' recommendations have not been implemented according to the deadlines set in the evaluation report and / or the factual situation in the institution is severely damaged in terms of quality.</p> <p>5. If the KAA withdraws the accreditation of an institution at the institutional level, it should notify MEST.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 22 E Drejta Ankimore</p>	<p style="text-align: center;">Član 22 Pravo na žalbu</p>	<p style="text-align: center;">Article 22 Appeals Procedure</p>
<p>1. Komisioni i Ankesave do të trajtoj dhe do të vendos për ankesat e</p>	<p>1. Žalbena komisija će razmatrati i odlučiti o žalbama podnetim od institucija visokog obrazovanja</p>	<p>1. The Appeal Commission shall review and decide on appeals</p>

<p>parashtruara nga institucionet e arsimit të lartë kundër vendimeve të KSHC-së.</p> <p>2. Ankesa parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KSHC-së në përputhje me Ligjin mbi Procedurën Administrative.</p> <p>3. Komisioni i Ankesave shqyrton ankesën dhe nxjerr vendim brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dorëzimit të ankesës.</p> <p>4. KSHC aprovon rregulloren e ankesave të AKA-së e cila specifikon procedurën ankimore që zhvillon Komisioni i Ankesave.</p> <p>5. Vendimi i nxjerrë lidhur me ankesën e parashtruar është përfundimtar. Ndaj këtij vendimi pala e pakënaqur mund të filloj konfliktin administrativ përmes padisë në gjykatën kompetente.</p> <p>6. Anëtarët e Komisionit të Ankesave do të jenë tre ekspertë në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e</p>	<p>protiv odluka DSK-a.</p> <p>2. Žalba se podnosi u roku od trideset (30) dana od dana kada je stranka obaveštena o odluci DSK-a u skladu sa Zakonom o upravnom postupku.</p> <p>3. Žalbena komisija razmatra žalbu i donosi odluku u roku od trideset (30) dana od dana podnošenja žalbe.</p> <p>4. DSK odobrava pravilnik o žalbama AKA koji precizira žalbeni postupak koji vodi Žalbena komisija.</p> <p>5. Odluka doneta prema podnetoj žalbi je konačna. Protiv ove odluke nezadovoljna strana može pokrenuti upravni spor kroz tužbu u nadležnom sudu.</p> <p>6. Članovi žalbene komisije će biti tri eksperata iz oblasti osiguranja kvaliteta u visokom obrazovanju.</p>	<p>submitted by higher education institutions against decisions rendered by the NQC.</p> <p>2. The appeal shall be lodged within a time limit of thirty (30) days following the day when the party was informed on the NQC decision, in accordance with the Law on Administrative Procedure.</p> <p>3. The appeal commission shall review appeals and render a decision within thirty (30) days from the day of receiving the appeal.</p> <p>4. NQC shall adopt the KAA's appeal regulation, which shall stipulate the appeal procedure employed by the Appeal Commission.</p> <p>5. Decisions rendered on the appeals shall be final. The unsatisfied party may initiate an administrative dispute against this decision by means of a lawsuit before a competent court.</p> <p>6. The Appeal Commission shall be composed of three experts in the field of higher education quality assurance. One of them shall be a</p>
---	--	---

<p>lartë. Njëri nga ta do të jetë një ish anëtarë ndërkombëtarë i KSHC-së, një ish anëtarë vendor i KSHC-së si dhe një ekspert ndërkombëtarë kompetent në fushën e arsimit të lartë në Kosovë.</p> <p>7. Anëtarët e Komisionit të Ankesave propozohen dhe emërohen nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA).</p>	<p>Jedan od njih će biti bivši međunarodni član DSK-a i jedan međunarodni ekspert nadležan u oblasti visokog obrazovanja na Kosovu.</p> <p>7. Članove Žalbene komisije predlaže i imenuje Agencija Kosova za akreditaciju (AKA).</p>	<p>former international member of NQC, one shall be a former domestic member of NQC, and the third shall be a competent international expert in the field of higher education in Kosovo.</p> <p>7. Members of the Appeal Commission shall be proposed and appointed by the Kosovo Accreditation Agency (KAA).</p>
<p>8. Anëtarët e Komisionit të Ankesave do të pranojnë kompensim mujor. Kryetari i Komisionit të Ankesave do të pranojë kompensim mujor prej 300 Euro në muaj, ndërsa dy anëtarët e tjerë do të pranojnë kompensim mujor prej 250 Eurove në muaj.</p>	<p>8. Članovi Žalbene komisije će dobiti mesečnu naknadu. Predsednik Žalbene komisije će dobiti mesečnu naknadu u iznosu od 300 evra, a ostala dva člana će dobiti mesečnu naknadu u iznosu od 250 evra.</p>	<p>8. Members of the Appeal Commission shall receive a monthly compensation. The Chairperson of the Appeal Commission shall receive a monthly compensation of EUR 300 per month, whereas the other two members shall receive a monthly compensation of EUR 250 per month.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 23 Programet e studimit me akreditim ndërkombëtar</p>	<p style="text-align: center;">Član 23 Studijski programi sa međunarodnom akreditacijom</p>	<p style="text-align: center;">Article 23 Study programs with international accreditation</p>
<p>1. Çdo institucion mund të propozojë të ofrojë në Kosovë programe të studimit</p>	<p>1. Svaka institucija može predložiti da na Kosovu pruža studijske programe</p>	<p>1. Every institution may propose to provide study programs in Kosovo that lead to obtaining an academic</p>

<p>të cilat shpijnë në marrjen e një grade akademike apo diplome të huaj, me kusht që këto programe të studimit të institucionit të huaj të arsimit të lartë janë të akredituara nga një agjenci e njohur e sigurimit të cilësisë nga ENQA, EQAR dhe CHEA.</p>	<p>koji vode ka dobijanju akademске titule ili strane diplome, pod uslovom da su ovi studijski programi inostrane institucije visokog obrazovanja akreditovana od poznate agencije osiguranja kvaliteta od ENQA, EQAR i CHEA.</p>	<p>degree or a foreign degree, provided that these study programs of the foreign higher education institution are accredited by a recognized quality assurance agency from ENQA, EQAR and CHEA.</p>
<p>2. Të gjitha këto propozime dhe kërkesa duhet te aprovohen nga AKA.</p>	<p>2. Svi ovi predlozi i zahtevi treba da budu odobreni od strane AKA.</p>	<p>2. All these proposals and requests must be approved by KAA.</p>
<p>3. Nëse programi i studimit ofrohet në Kosovë drejtpërdrejt nga një institucion i huaj i arsimit të lartë përmes një marrëveshje të bashkëpunimit apo franshizës me një institucion të arsimit të lartë të Kosovës, mirëpo që nuk ofron gradë akademike apo diplomë të Kosovës, AKA do të organizojë procedurë të vlerësimit me ekspertë të huaj me qëllim që të kontrolloj:</p>	<p>3. Ukoliko se studijski program pruža direktno na Kosovu od strane inostrane institucije visokog obrazovanja putem sporazuma o saradnji ili licence sa institucijom visokog obrazovanja Kosova, ali koja ne pruža akademsko zvanje ili diplomu Kosova, AKA će uspostaviti proceduru ocenjivanja sa spoljašnjim ekspertima u cilju kontrolisanja:</p>	<p>3. If the study program is offered in Kosovo directly by a foreign higher education institution through a cooperation or franchise agreement with a higher education institution of Kosovo, but does not offer an academic degree or diploma in Kosovo, KAA will organize an evaluation procedure with external evaluators in order to check:</p>
<p>3.1. vlefshmërinë e akreditimit ndërkombëtarë sipas legjislacionit vendor dhe ESG 2015 dhe;</p>	<p>3.1. validnosti međunarodne akreditacije u skladu sa domaćim zakonodavstvom i ESG 2015 i;</p>	<p>3.1. The validity of international accreditation according to local legislation and ESG 2015 and;</p>
<p>3.2. që konteksti arsimor dhe kërkimor si dhe kushtet e ofruara në kampusin në Kosovë janë të cilësisë së njëjtë sikurse në programin e ofruar dhe akredituar</p>	<p>3.2. da su istraživački i obrazovni kontekst kao i uslovi koji se pružaju u kampusu na Kosovu istog kvaliteta kao oni u programu pruženom i akreditovanom u zemlji porekla, ali</p>	<p>3.2. that the educational and research context as well as the conditions offered on the campus in Kosovo are of the same quality as the offered and</p>

<p>në vendin e origjinës, por marr parasysh edhe kriteret minimale të cilësisë të përcaktuara me këtë UA për sa i përket stafit akademik.</p> <p>4. Nëse grada akademike/ diploma ofrohet së bashku me një gradë akademike apo diplomë nga Kosova (diplomë e dyfishtë apo marrëveshje për diplomë të përbashkët) duhet të zbatohen gjitha procedurat, kriteret dhe standardet e përcaktuara në UA në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 24 Standardet e akreditimit</p>	<p>imajući u vidu minimalne kriterijume kvaliteta koji su definisani ovim AU-om što se tiče akademskog osoblja.</p> <p>4. Ako se akademsko zvanje/diploma pružaju zajedno sa akademskim zvanjem ili diplomom iz Kosova (dvostruka diploma ili sporazum o zajedničkim diplomama) treba sprovesti sve procedure, kriterijume i standarde definisane u važećem AU.</p> <p style="text-align: center;">Član 24 Standardi akreditacije</p>	<p>accredited program in the country of origin, but also take into account the minimum quality criteria set out in this AI with regard to academic staff.</p> <p>4. If academic degrees / diplomas are offered together with an academic degree or diploma from Kosovo (dual diploma or agreement for mutual diploma) all procedures, criteria and standards set out in the AI in force must be applied.</p> <p style="text-align: center;">Article 24 The accreditation standards</p>
<p>1. Standardet e akreditimit në këtë udhëzim administrativ janë formuluar në formë të rregullave të cilat përkufizojnë nivelin minimal dhe obligativ që duhet të arrihen nga institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>2. Standardet e akreditimit në këtë udhëzim administrativ bazohen në praktikat evropiane dhe globale të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë,</p>	<p>1. Standardi akreditacije u ovom administrativnom uputstvu su formulisani u obliku propisa koji definišu minimalni i obavezni nivo koji se treba ispuniti od strane institucija visokog obrazovanja.</p> <p>2. Standardi akreditacije u ovom administrativnom uputstvu sa baziraju na evropske i globalne prakse osiguranja kvaliteta u</p>	<p>1. The accreditation standards in this Administrative Instruction are formulated in the form of rules that define the minimum and mandatory level to be achieved by higher education institutions.</p> <p>2. The accreditation standards in this Administrative Instruction are based on European and global quality assurance policies in</p>

<p>duke u bazuar por mos u kufizuar vetëm në Ligjin për Arsimin e Lartë në Kosovë, Udhëzuesit dhe Standardet Evropiane të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>3. Akreditimi i një institucioni të arsimit të lartë dhe programeve të tij të studimit bazohet në arritjet e nivelit minimal të të gjitha standardeve të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ.</p>	<p>visokom obrazovanju, bazirajući se ali ne ograničavajući se samo na zakonu o visokom obrazovanju na Kosovu, Smernicama i Evropskim standardima osiguranja kvaliteta.</p> <p>3. Akreditacija institucije visokog obrazovanja i njegovih programa studija se zasniva na dostignućima minimalnog nivoa svih standarda definisanih u ovom Administrativnom uputstvu.</p>	<p>higher education, being based but not limited only on the Law on Higher Education in Kosovo, European Guidelines and Standards for Quality Assurance in Higher Education.</p> <p>3. The accreditation of a higher education institution and its study programs are based on achievements of the minimum level of all the standards set out in this Administrative Instruction.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 25 Standardet e cilësisë për akreditim institucional</p>	<p style="text-align: center;">Član 25 Standardi kvaliteta za institucionalnu akreditaciju</p>	<p style="text-align: center;">Article 25 Quality standards for institutional accreditation</p>
